



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 47 paragrafit (1) pikës 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10 dhe 123/12), nenit 17, paragrafit (5) dhe nenit 22 paragrafit (2) të Ligjit për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10 dhe 26/13) dhe nenit 56 nga Ligji për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

V E N D I M **për dhënien e lejeve¹**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet:

- mënyra dhe lloji i paraqitjes së dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve dhe procedura e vlerësimit të tyre gjatë dhënies së lejes për themelimin dhe operimin e bankës;
- mënyra dhe lloji i paraqitjes së dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve dhe procedura e vlerësimit të tyre gjatë dhënies së lejes për themelimin dhe operimin e bankës së kontrolluar nga një bankë e huaj dhe/ose person i huaj me pjesëmarrje në bankë të huaj;
- dokumentacioni, procedura dhe kriteret për marrjen e lejes për ndryshime statusore të bankës;
- Dokumentacioni dhe procedura për dhënien e lejes për ndryshim statusor dhe/ose transformimin e kursimores në bankë.

II. DHËNIE LEJE PËR THEMELIMIN DHE OPERIMIN E BANKËS

2. Për dhënien e lejes së përkohshme për themelim dhe operim të bankës, deri te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore) dorëzohet dokumentacioni si vijon:

2.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për themelim dhe për operim të bankës (formulari 1).

2.2. Propozim-akt për themelim, i cili duhet ti përmbajë të paktën këto të dhëna:

¹ Teksti jozyrtar i konsoliduar i Vendim për dhënien e lejeve përbëhet nga Vendimi për dhënien e lejeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.72/13), Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për dhënien e lejeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.24/18) dhe Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për dhënien e lejeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.50/19).

- emri dhe selia e bankës;
- aktivitetet financiare që do t'i kryej banka;
- shumën e kapitalit fillestar;
- shuma nominale e aksioneve, numri i aksioneve të çdo lloje dhe klase, të drejtat, detyrimet, kufizimet dhe përfitimet që rrjedhin nga aksionet;
- mënyrën e përvetësimit dhe përfundimin e të drejtave të aksionarëve të bankës;
- procedurë për thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes;
- për personin që synon të themelojë një bankë - person fizik vendas: emri dhe mbiemri dhe numri i vetëm amë; për personin që synon të themelojë një bankë - person fizik i huaj: emri dhe mbiemri, nënshtetësia, vendi i banimit dhe numri i pasaportës ose dokumenti tjetër, i vlefshëm në vendin e tij, për të vërtetuar identitetin e tij; për personin që synon të themelojë një bankë - person juridik vendas dhe i huaj: emër, seli dhe numër unik amë të personit (ose numër tjetër unik të identifikimit, të vlefshëm në vend);
- llojin, përbërjen, numrin, mënyrën dhe kushtet e përzgjedhjes, kohëzgjatjen e mandatit, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të organeve të bankës;
- numrin, kohëzgjatjen e mandatit, të drejtat, përgjegjësitë dhe kushtet për emërimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë;
- mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve të bankës;
- mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave të bankës;
- përfaqësimin e bankës nga anëtarët e bordit drejtues;
- forma dhe mënyra e publikimit të të dhënave nga banka;
- kushtet dhe rastet e ndërprerjes së punës së bankës.

2.3. Plani strategjik dhe operativ i bankës të paktën duhet të përfshijë:

- 2.3.1. Arsyetimi, pra analiza e arsyeve për themelimin e një banke dhe qëllimet afariste të bankës.
- 2.3.2. Një pasqyrë e tregut në të cilin banka do të marrë pjesë, strukturës së klientëve të bankës dhe llojit të aktiviteteve financiare që do të kryejë banka, duke përfshirë aktivitetet për të cilat banka ndoshta synon të specializohet, si dhe mënyrën në të cilën do të arrihet specializimi.
- 2.3.3. Përshkrim i sistemeve të udhëheqjes me rreziqet dhe kontrolli të brendshëm;
- 2.3.4. Numri dhe lokacioni i filialeve, ekspoziturave dhe pjesëve tjera, si dhe afati kur banka synon t'i hapë ato.
- 2.3.5. Struktura organizative e bankës, me përshkrim të veçantë të fushës së punës dhe të përgjegjësi të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe të çdo pjese organizative, marrëdhëniet e ndërsjella dhe marrëdhëniet me autoritetet e bankës, si dhe përshkrimin e numrit të kërkuar të punonjësve dhe strukturën e tyre kualifikuese.
- 2.3.6. Parashikimi i fushës dhe natyrës së aktiviteteve financiare që do të kryejë banka dhe plani i aksionerëve për zhvillimin e ardhshëm të bankës, në drejtim të rritjes së fondeve të saj për pesë vitet e ardhshme, si dhe një parashikim të raporteve financiare për pesë vitet e ardhshme, ndërsa për vitin e parë parashikimet duhet të përgatiten në baza tremujore. Parashikimet duhet të përmbajnë:

- bilanc të detajuar, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e fluksit monetar me komente për secilin pozicion dhe supozimet bazë në të cilat bazohet projeksioni;
- lëvizja e treguesve financiarë dhe standardeve mbikëqyrëse, si raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, shtresat mbrojtëse të kapitalit, treguesit e likuiditetit, përfitueshmërisë dhe ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera materiale;
- lëvizja e treguesve financiarë dhe e standardeve mbikëqyrëse të vendosura mbi baza të konsoliduara, nëse banka synon të investojë në institucione të tjera financiare bankare dhe jobankare në pesë vitet e para të funksionimit, duke formuar kështu një grup bankar.

2.3.7. Datën e planifikuar e fillimit të punës.

2.4. Të dhëna për identitetin, arsimimin, përvojën dhe historinë profesionale etëanëtarëve të propozuar të këshillit mbikëqyrës dhe drejtues;

2.5. Të dhëna për sistemin informativ dhe pajisjet teknike të bankës, në aspektin e aftësisë së saj për të kryer aktivitetet e planifikuara financiare, ku:

- dokumentacioni për sistemin informativ duhet të bazohet në standardet minimale për sigurinë e sistemit informativ dhe për sigurimin e vazhdimësisë në operacione, në përputhje me vendimin për sigurinë e sistemit informativ të bankës. Nëse parashikohet që funksionimi i sistemit informativ varet nga përdorimi i shërbimeve nga persona të jashtëm (shoqëri e shërbimeve ndihmëse bankare), do të paraqiten të dhënat e duhura për zbatimin e standardeve të sigurisë së sistemit informativ dhe për sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve nga ata persona;
- dokumentacioni i pajisjeve teknike duhet të përmbajë të dhëna për hapësirën afariste ku do të operojë banka, duke përfshirë filialet, ekspoziturat dhe njësitë e tjera të planifikuara afariste, për hapësirën afariste ku do të vendoset vendndodhja rezervë e bankës (pronësi e bankës, me qira, vendndodhjen, zonën dhe dinamikën të pajisjeve të vënies në punë të tij) dhe pajisjeve teknike që do të përdorë, dokumentacioni për karakteristikat bazë të serverëve, lidhjen e komunikimit dhe bazat e të dhënave që do të përdoren, si dhe për metodën e funksionimit të komponentëve kryesorë të sistemit të informacionit dhe zgjidhjeve aplikative.

2.6. Të dhëna për personat që synojnë të themelojnë një bankë dhe atë:

2.6.1. Të dhëna për personat juridik:

- Pyetsor i plotësuar për personat juridik që synojnë të themelojnë një bankë (formulari 2) ;
- vendim i organit kompetent të personit juridik për pjesëmarrje në themelimin e një banke;
- deklaratë e nënshkruar nga një autoritet kompetent i personit juridik, e dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, për origjinën e fondeve që janë investuar, pra bazën për blerjen e aksioneve në bankë, duke i bashkangjitur dëshminë përkatëse të burimit të fondeve që personi i investon në bankë (raport i auditimit, llogari vjetore ose dëshmi tjetër e përshtatshme);

- vërtetim nga gjykata kompetente ose institucioni tjetër kompetent se nuk ka sanksion ose dënim kundërvajtës me të cilin ndalohet veprimtaria ndaj personit juridik;
- vërtetim nga gjykata kompetente ose institucion tjetër kompetent se personit juridik nuk i është shqiptuar dënim dytësor: ndalimi i marrjes së licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës, heqja e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës, ndalimi i themelimit të personave të rinj juridik dhe ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm për kryerjen e veprimtarive bankare;
- deklaratë e nënshkruar nga organi kompetent i personit juridik, e dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, për ekzistimin ose mosekzistencën e lidhjes me persona të tjerë që synojnë të krijojnë bankën, si dhe për lidhje me persona të tjerë juridikë dhe fizikë në përputhje me Ligjin për bankat;
- vërtetim nga Drejtoria e të Hyrave Publike ose vërtetim nga institucioni përkatës (për persona të huaj) për pagesë të rregullt të tatimeve dhe kontributeve dhe vërtetim nga institucioni kompetent se nuk është ngarkuar me detyrime ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë juridikë dhe fizikë;
- vërtetim nga institucioni kompetent se ndaj personit juridik nuk është hapur procedurë falimentimi apo likuidimi;
- Raporte rishikimi për personin juridik për tre vitet e fundit. Personat juridik të themeluar dhe që operojnë më pak se tre vjet, janë të detyruar të sigurojnë raporte rishikimi për tre vitet e fundit për aksionarët e tyre - persona juridik, pra të paraqesin dokumentacion përkatës nga nënpika 2.6.2 e kësaj pike për aksionerët e tyre - persona fizik që kanë pjesëmarrje në kapitalit e personit juridik mbi 10%. Raporti i rishikimit që paraqitet për personin e huaj juridik i cili synon themelimin e një banke ose për aksionerët e tij - persona juridik, duhet të hartohet nga firma ndërkombëtare e rishikimit;
- deklaratë e nënshkruar nga organi kompetent i personit juridik, e dhënë nën përgjegjësinë e plotë materiale dhe penale, pavarësisht nëse ai vepron bashkërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet marrëveshjes formale ose joformale, me persona të tjerë që synojnë të themelojnë një bankë ose me persona të tjerë, të cilët do të kishin kontroll mbi bankën;
- një paraqitje skematike e strukturës së pronësisë së personit juridik deri te pronari real - personi fizik.

Një person juridik që synon të merr një pjesëmarrje të kualifikuar në bankë i paraqet edhe këto dokumente:

- certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar selia e personit juridik;
- aktin e themelimit të personit juridik dhe listën e anëtarëve të organeve të tij drejtuese;
- listë e personave të cilët në personin juridik zotërojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 10% të aksioneve, pra të pjesëve dhe
- listë e personave juridik në të cilat personi juridik zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 10% të aksioneve, pra pjesëve, me raporte financiare për tre vitet e fundit.

Detyrimi nga paragrafi (2), nënparagrafi (4) i kësaj nënpike i referohet raporteve financiare të rishikuara në bazë të konsoliduar, nëse personi juridik që synon të marrë një pjesëmarrje të kualifikuar në një bankë ka detyrimin të përgatisë raporte

të tilla, në përputhje me rregulloret e kontabilitetit në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtetin ku ndodhet selia e personit juridik.

2.6.2. Të dhëna për personat fizik:

- Pyetsor i plotësuar për personat fizik që synojnë të themelojnë një bankë (formulari 3). Plotësohen të dhënat (emri dhe mbiemri, vendi dhe data e lindjes, adresa e banimit, numri unik amë dhe numri i letërnjoftimit) të personit fizik, marrë nga letërnjoftimi, ose paraqitet një kopje e pasaportës për personin fizik të huaj. Përveç të dhënave për personin fizik, të marra nga letërnjoftimi, një deklaratë nga personi se këto janë të dhëna të tij dhe të sakta, e vërtetuar nga personi i autorizuar (noter);
- një deklaratë e dhënë nën përgjegjësinë e plotë penale dhe materiale, për origjinën e fondeve që investohen, pra bazën e blerjes së aksioneve në bankë, duke i bashkangjitur dëshminë përkatëse të burimit të fondeve që personi investon në bankë (vendim trashëgimie, konfirmim nga një bankë ose institucion tjetër financiar për shumën dhe datën e fondeve të investuara, një dokument mbi shumën e pagës dhe të ardhurave të fituara në baza të tjera dhe dëshmi të tjera të përshtatshme);
- vërtetim nga gjykata kompetente apo institucioni tjetër kompetent se personit fizik nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës ose ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- deklaratë e dhënë nën përgjegjësinë e plotë penale dhe materiale, për ekzistimin ose mosekzistimin e lidhjes me persona të tjerë që synojnë të themelojnë bankë, si dhe për lidhje me persona të tjerë juridikë dhe fizikë, në përputhje me Ligjin për bankat;
- vërtetim nga Drejtoria e të Hyrave Publike ose vërtetim nga institucioni përkatës (për persona të huaj) për pagesë të rregullt të tatimeve dhe kontributeve dhe vërtetim nga institucioni kompetent se nuk është ngarkuar me detyrime ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë juridikë dhe fizikë;
- një deklaratë e bërë nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, pavarësisht nëse ai vepron bashkërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një marrëveshjeje formale ose joformale, me persona të tjerë që synojnë të krijojnë një bankë ose me persona të tjerë që do të kishin kontroll mbi bankën;
- deklaratë e bërë nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, së bashku me një person tjetër fizik drejtpërdrejt ose tërthorazi dhe/ose nëpërmjet një marrëveshjeje, ushtron kontroll mbi një shoqëri tregtare vendase ose të huaj.

Banka Popullore, sipas detyrës zyrtare, jep vërtetim për (mos)dënimin e personit që synon të themelojë bankë, në kuptim të nenit 13 paragrafi (3) të Ligjit për Bankat, nga gjykata kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nëse personi fizik i cili synon të themelojë bankë ka bashkëpunëtor në kuptim të Ligjit për Bankat, Banka Popullore sipas detyrës zyrtare jep vërtetimin për (mos)dënimin e bashkëpunëtorit nga gjykata kompetente. Nëse bëhet fjalë për persona të huaj, certifikatat e tilla të lëshuara nga institucionet kompetente në shtetin e huaj duhet t'i paraqiten kërkesës për lëshimin e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës.

Banka Popullore, sipas detyrës zyrtare, mund të kërkojë edhe dokumente, të dhëna dhe informacione shtesë nga organi kompetent kompetent në vend ose jashtë

vendit për të vlerësuar reputacionin ose integritetin e personave që synojnë të themelojnë bankë.

3. Dokumentacioni shtesë që mund të kërkohet nga Guvernatori i Bankës Popullore (në tekstin e mëposhtëm: Guvernatori), në përputhje me Ligjin për Bankat, për marrjen e vendimit për kërkesën për dhënien e licencës për themelimin dhe funksionimin e një banke, mund të referohen në veçanti dokumentet, të dhënat dhe informacionet e mëposhtme, por jo ekskluzivisht:

- certifikatë mbi gjendjen e llogarive bankare të personit që synon të themelojë një bankë, për një periudhë të caktuar;
- të dhëna për gjendjen juridike, gjendjen financiare dhe strukturën e pronësisë së personave që ushtrojnë kontroll tek personi që synon të themelojë një bankë;
- të dhëna për përbërjen e grupit bankar ose një grupi tjetër brenda ose jashtë vendit, nëse personi që synon të themelojë një bankë është anëtar i një grupi të tillë, me një listë të personave individualë në grup dhe një përshkrim të lidhjes së tyre;
- raporte të rishikuara financiare të anëtarëve tjerë në grupin bankar ose në një lloj tjetër të grupit, nëse personi i cili synon të themelojë një bankë është anëtarë i një grupi të tillë, ose të personave të tjerë që, sipas Ligjit për Bankat, konsiderohen persona të lidhur me personin që synon të themelojë një bankë, veprimtaria e së cilës mund të ketë ndikim në operimin dhe/ose rreziqet ndaj të cilave do të mund të ekspozohet banka;
- raportet financiare në bazë të konsoliduar për grupin e përbërë nga personi që synon të themelojë një bankë dhe personat që në përputhje me Ligjin për Bankat konsiderohen persona të lidhur me atë person, nëse ai grup është i ndryshëm nga grupi për të cilin raporti financiar i rishikuar në bazë të konsoliduar është paraqitur në përputhje me paragrafin (3) të nënpikës 2.6.1 nga ky vendim.

4. Lidhur me kërkesën për dhënien e lejes së përkohshme për themelim dhe operim, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e lejes së përkohshme ose për refuzimin e kërkesës, në afat e përshkruara me Ligjin për Bankat.

Guvernatori do të refuzojë kërkesën nga paragrafi (1) i kësaj pike nëse, sipas vlerësimit nga pika 7 e këtij vendimi, përcakton se nuk janë plotësuar kriteret e përshkruara me Ligjin për Bankat.

5. Për dhënien e lejes për themelim dhe operim, banka është e detyruar ti plotësojë kushtet e përcaktuara në lejën e përkohshme në afatin e përcaktuar në Ligjin për Bankat dhe për këtë Bankës Popullore i paraqet këto dëshmi:

5.1. Dëshmi se është paguar kapitali fillestar në llogari të përkohshme të mbajtësi i qarkullimit pagesor, pra dëshmi se personi i huaj juridik ose fizik i ka paguar mjetet valutore në llogari të veçantë në Bankën Popullore.

5.2. Statut i cili duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

- emri dhe selia e bankës;
- aktivitetet financiare që do t'i kryej banka;
- shumën e kapitalit fillestar;

- shuma nominale e aksioneve, numri i aksioneve të çdo lloje dhe klase, të drejtat, detyrimet, kufizimet dhe përfitimet që rrjedhin nga aksionet;
- mënyrën e përvetësimit dhe përfundimin e të drejtave të aksionarëve të bankës;
- procedurë për thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes;
- për personin që synon të themelojë një bankë - person fizik vendas: emri dhe mbiemri dhe numri i vetëm amë; për personin që synon të themelojë një bankë - person fizik i huaj: emri dhe mbiemri, nënshtetësia, vendi i banimit dhe numri i pasaportës ose dokumenti tjetër, i vlefshëm në vendin e tij, për të vërtetuar identitetin e tij; për personin që synon të themelojë një bankë - person juridik vendas dhe i huaj: emër, seli dhe numër unik amë të personit (ose numër tjetër unik të identifikimit, të vlefshëm në vend);
- llojin, përbërjen, numrin, mënyrën dhe kushtet e përzgjedhjes, kohëzgjatjen e mandatit, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të organeve të bankës;
- numrin, kohëzgjatjen e mandatit, të drejtat, përgjegjësitë dhe kushtet për emërimin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë;
- mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet aksionarëve të bankës;
- mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave të bankës;
- ndarja e kompetencave të anëtarëve të bordit drejtues të bankës, nëse planifikohet ndarje e tillë dhe përfaqësimin e bankës nga anëtarët e bordit drejtues;
- forma dhe mënyra e publikimit të të dhënave nga banka;
- kushtet dhe rastet e ndërprerjes së punës së bankës.

5.3. Të dhëna për identitetin, arsimin, përvojën dhe historinë profesionale të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta (formulari i plotësuar 4), me përjashtim të anëtarëve të bordit mbikëqyrës dhe drejtues. Plotësohen të dhënat (emri dhe mbiemri, vendi dhe data e lindjes, adresa e banimit, numri unik amë dhe numri i letërnjoftimit) të personit fizik, marrë nga letërnjoftimi, respektivisht dorëzohet kopje e pasaportës nëse personi është person fizik i huaj. Bashkangjitur me të dhënat e personit fizik, të marra nga letërnjoftimi, paraqitet deklarata e personit se këto janë të dhëna të tij dhe të sakta, e vërtetuar nga personi autorizuar (noter).

5.4. Numri i punonjësve sipas pjesëve të veçanta organizative dhe nëse është e nevojshme, paraqitet një plan për arritjen e numrit të planifikuar të punonjësve.

5.5. Vërtetim për marrjen me qira ose blerjen e hapësirave afariste dhe pajisjeve për funksionimin e bankës dhe njësive të saj të biznesit dhe ngritjen e sistemit të informacionit.

5.6. Të dhënat për sistemin dhe politikat e menaxhimit të rrezikut dhe aktet e brendshme të menaxhimit të rrezikut të bëra në përputhje me Ligjin për Bankat dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit për Bankat, të cilat i referohen:

- menaxhimi me rrezikun kreditor;
- menaxhimi me rrezikun e përqendrimit të ekspozimit të bankës;
- menaxhimi me rrezikun likuidues;
- menaxhimi me rrezikun e tregut;
- menaxhimi me rrezikun nga ndryshimi i normave të interesit në portofolin e aktiviteteve bankare;

- menaxhimi me rrezikun valutor;
- menaxhimi me rrezikun operativ, përfshirë edhe rrezikun e pamjaftueshmërisë së sistemeve të informacionit (politika për sigurinë e sistemit të informacionit dhe për sigurimin e vazhdimësisë së punës) dhe rrezikut nga larja e parave dhe financimit të terrorizmit (programi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit);
- menaxhimi me rrezikun juridik;
- menaxhimi me rreziqet tjera materiale mbi të cilat do të ekspozohet banka varësisht nga aktivitetet financiare të cilat i kryen.

5.7. Politika dhe procedura të shkruara për punën e bankës dhe atë për:

- procesin e vendimmarrjes dhe përgjegjësitë e individëve të përfshirë në atë proces;
- funksionimi i sistemit të kontrollës së brendshme;
- punën e Shërbimit të Auditimit të Brendshëm dhe planin e auditimit të brendshëm për të paktën dy vitet e para të funksionimit të bankës;
- kontabilitet;
- shpërblimi i personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe punonjësve të tjerë dhe
- sjellja etike (kodi etik)
- menaxhimi korporativ (kodi për menaxhim korporativ);
- shmangia e konfliktit të interesave;
- mënyra e përzgjedhjes, monitorimit të punës dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, bordit të administrimit të rrezikut, bordit të auditimit dhe bordit drejtues.

5.8. Dëshmi (letër qëllimi, protokoll negociatash, etj.) për punësimin e një shoqërie auditimi.

6. Së bashku me kërkesën për dhënien e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës, Bankës Popullore i paraqitet edhe:

- dokumentacioni për dhënien e pëlqimit për emërimin e anëtarit të bordit mbikëqyrës dhe drejtues në përputhje me Vendimin për dhënien e pëlqimit, ku me rastin e vlerësimit të personave të propozuar si anëtarë të mbikëqyrjes dhe të bordit drejtues të bankës zbatohet metoda dhe procedura e përcaktuar në Vendimin për dhënien e pëlqimeve;
- kërkesë për dhënien e pëlqimit për fillimin e kryerjes së një aktiviteti financiar për të cilin në përputhje me Ligjin për Bankat kërkohej pëlqimi paraprak nga guvernatori, me ç'rast dokumentacioni, mënyra e dorëzimit të tij dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit për fillimin për kryerjen e një veprimtarie financiare zbatohen dispozitat e Vendimit për dhënien e pëlqimeve.

7. Gjatë vendosjes për dhënien e lejes vlerësohet nëse banka i plotëson kriteret e përcaktuara me Ligjin për Bankat, të paktën përmes:

- përcaktimit të identitetit të personave që synojnë themelimin e një banke, personat të cilët në përputhje me Ligjin për Bankat konsiderohen sikur persona të lidhur me ato dhe formën e tyre juridike;

- përcaktimi nëse gjendja financiare e personave që synojnë të themelojnë një bankë është e përshtatshme në lidhje me vlerën e aksioneve që ata synojnë të blejnë;
- vlerësimi i mundësive për mbështetjen e rritjes së planifikuar të fondeve të veta të bankës nga personat që synojnë të krijojnë një bankë;
- përcaktimi i burimit të fondeve, origjinës dhe ligjshmërisë së tyre;
- cilësisë dhe realitetit të planit strategjik dhe operativ. Plani vlerësohet nga këndvështrimi i mënyrës së parashikuar të menaxhimit të rreziqeve në operacion, mënyra e vendosjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, realiteti i projeksionit të aktiviteteve financiare dhe raporteve financiare dhe mundësia e realizimit të planit të aksionarëve për zhvillimin e ardhshëm të bankës;
- vlerësimi i përshtatshmërisë së numrit të nevojshëm të punonjësve në bankë për menaxhimin dhe funksionimin efikas dhe të suksesshëm të saj. Numri i nevojshëm i punonjësve nënkupton numrin që jep siguri se banka do të kryejë rregullisht dhe normalisht vëllimin e planifikuar të aktiviteteve;
- vlerësimi i kualifikimit, përvojës, trajnimit dhe reputacionit të anëtarëve të bordit mbikëqyrës dhe drejtues dhe vlerësimi i reputacionit të personave që synojnë të themelojnë një bankë. Do të konsiderohet se anëtarët e propozuar të bordit mbikëqyrës dhe drejtues, si dhe personat që synojnë të themelojnë një bankë, kanë një reputacion të përshtatshëm nëse janë të ndershëm, kompetent, punëtorë dhe ofrojnë siguri se puna e tyre nuk do të rrezikojë stabilitetin dhe sigurinë e bankës dhe nuk do të dëmtojë reputacionin dhe besimin e saj. Kjo do të thotë se për këta persona nuk ka asnjë provë për përfshirjen e tyre të mëparshme në operacione ose aktivitete që nënkuptonin mosrespektim të rregulloreve dhe praktikave dhe procedurave të biznesit, mosrespektim të rregullave të qeverisjes së mirë të korporatës, shkelje ose rrezikim të interesave të person juridik ku kanë punuar ose punojnë dhe për interesat e kreditorëve të tij, bashkëpunim joadekuat ose refuzim për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente, përfshirë autoritetet mbikëqyrëse, refuzim, revokim ose tërheqje të pëlqimit për një aksionar ose për kryerjen e një funksioni të caktuar nga autoriteti kompetent, duke përfshirë autoritetin mbikëqyrës. Reputacioni i duhur nënkupton edhe dëshminë e dosjes kriminale të këtyre personave në kuptim të nenit 13 paragrafi (3) dhe nenit 83 paragrafi (3) të Ligjit për Bankat, duke përfshirë evidencën penale të bashkëpunëtorit të personit fizik i cili synon të themelojë një bankë ose i cili propozohet për anëtar të bordit drejtues;
- vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit të informacionit dhe pajisjeve teknike të bankës për kryerjen e suksesshme dhe të besueshme të aktiviteteve financiare. Sistemi informativ konsiderohet adekuat nëse mundëson mbështetje të vazhdueshme dhe të besueshme të operacioneve të bankës dhe ofron bazë për raportim në kohë dhe të saktë të personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta dhe të Banka Popullore. Banka duhet të ketë hapësirë adekuate të biznesit dhe pajisje teknike që do të mundësojnë funksionimin e sigurt dhe të qetë të tij, si dhe përkufizimin e duhur të proceseve të biznesit;
- vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit bazuar në proceset e vendosura dhe zgjidhjen softuerike për monitorimin e rrezikut të ekspozimit të bankës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- vlerësimi i përshtatshmërisë së strukturës organizative të bankës, që nënkupton të paktën përcaktimin e procedurave të punës për të gjitha

proceset e biznesit që do të zhvillohen në bankë, në përputhje me aktivitetet e planifikuara financiare, përcaktimin e linjave të vendim-marrjes, krijimin dhe përgjegjësinë dhe vendosjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm në të gjitha proceset e biznesit që përfshijnë një nivel të caktuar rreziku;

- vlerësimin e vendosjes organizative të bankës për administrimin e rreziqeve ndaj të cilave do të ekspozohet gjatë kryerjes së aktiviteteve të planifikuara financiare;
- përcaktimin nëse banka ka kapacitetin për të përmbushur standardet e përcaktuara mbikëqyrëse;
- përcaktim nëse në kërkesën ka mospërputhje të cilat nuk mund të shpjegohen;
- të vlerësojë nëse ekzistenca e lidhjeve të ngushta ose struktura organizative ose pronësore e bankës ose grupit të cilit do t'i përkasë nuk e vështirëson kryerjen e mbikëqyrjes efektive dhe marrjen e masave korrigjuese, në baza individuale ose të konsoliduara.

8. Guvernatori merr vendim për lëshimin e licencës për themelimin dhe funksionimin e një banke ose refuzimin e kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Bankat.

III. DHËNIE LEJE PËR THEMELIMIN DHE OPERIMIN E BANKËS SË KONTROLLUAR NGA NJË BANKË E HUAJ DHE/OSE NGA NJË PERSON I HUAJ ME PJESËMARRJE NË BANKË

9. Drejt kërkesës për dhënien e lejes për themelimin dhe operimin e një banke të kontrolluar nga një bankë e huaj dhe/ose person i huaj me pjesëmarrje në bankë të huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 dhe dokumentacionin dhe kërkesat nga pika 6 e këtij vendimi, banka e huaj dhe/ose personi i huaj janë të detyruar deri te Banka Popullore të paraqesin edhe dokumentacionin vijues:

- certifikatë nga regjistri në të cilin është regjistruar selia e bankës së huaj dhe/ose personi i huaj, ku tregohet forma ligjore dhe data e regjistrimit;
- vërtetimin se banka e huaj, gjegjësisht banka e huaj në të cilën personi i huaj ka aksione, është e autorizuar të mbledhë depozita dhe burime të tjera të rimbursueshme të fondeve në vendin në të cilin është regjistruar selia e saj;
- mendim nga organi kompetent i shtetit në të cilin është regjistruar selia e bankës së huaj, përkatësisht e bankës së huaj në të cilën personi i huaj ka pjesë, lidhur me marrjen e kontrollit në një bankë në Republikën e Maqedonisë;
- vërtetimin se autoriteti kompetent i vendit në të cilin është regjistruar selia e bankës së huaj, pra i bankës së huaj në të cilën personi i huaj ka pjesëmarrje, ushtron mbikëqyrjen e duhur në bazë të konsoliduar, duke dhënë të dhëna për rregulloren, politikat dhe praktikën në fushën e mbikëqyrjes në baza të konsoliduara.

10. Dokumentacioni shtesë që guvernatori mund të kërkojë në përputhje me Ligjin për Bankat, për të vendosur mbi kërkesën për lëshimin e licencës për themelimin dhe funksionimin e një banke të kontrolluar nga një bankë e huaj dhe/ose një person i huaj me pjesëmarrje në një bankë të huaj, mund t'i referohet veçanërisht, por jo ekskluzivisht, dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve të mëposhtme:

- raportet e auditimit të bankës së huaj në të cilën personi i huaj ka aksione për tre vitet e fundit, të përgatitura nga një shoqëri auditimi ndërkombëtare;
- një historik i shkurtër i operacioneve dhe aktiviteteve financiare të kryera nga banka e huaj, pra banka e huaj në të cilën personi i huaj ka aksione;
- të dhënat për linjat e raportimit që do të vendosen ndërmjet bankës dhe autoriteteve të bankës së huaj;
- investimet ekzistuese ose të planifikuara në banka ose institucione të tjera financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në vende të tjera nga banka e huaj ose personi i huaj;
- pasqyrat financiare të audituara të personave të tjerë, anëtarë të një grupi bankar, në të cilin është anëtare banka e huaj, gjegjësisht banka e huaj në të cilën personi i huaj ka pjesëmarrje dhe/ose persona të tjerë të cilët sipas Ligjit për Bankat konsiderohen personat e lidhur me bankën e huaj, d.m.th. banka e huaj, një bankë në të cilën personi i huaj ka pjesëmarrje, operacioni i së cilës mund të ketë ndikim në operacionin dhe/ose rreziqet ndaj të cilave do të ekspozohet banka bazë;
- deklaratë e nënshkruar nga organi kompetent i bankës së huaj ose personi i huaj, se banka që themelohet do të respektojë standardet mbikëqyrëse të përcaktuara me Ligjin për bankat dhe se do të dorëzojë të dhënat që Banka Popullore do t'i kërkojë prej saj për të kryer mbikëqyrje efikase të fondacionit individual dhe të konsoliduar;
- deklaratë nga organi kompetent i vendit në të cilin është regjistruar selia e bankës së huaj, gjegjësisht banka e huaj në të cilën personi i huaj ka pjesëmarrje, se është i gatshëm të bashkëpunojë me Bankën Popullore në aspektin e respektimit të parimeve ndërkombëtare dhe standardet për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për kryerjen e mbikëqyrjes efektive.

11. Pas kërkesës për dhënien e lejes për themelimin dhe operimin e një banke të kontrolluar nga një bankë e huaj ose një person i huaj me pjesëmarrje në një bankë të huaj, guvernatori merr vendim për lëshimin e një lejes së përkohshme ose refuzimin e kërkesës, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Bankat.

Guvernatori do të refuzojë kërkesën nga paragrafi (1) i kësaj pike nëse, sipas vlerësimit nga pika 13 e këtij vendimi, përcakton se nuk janë plotësuar kriteret e përshkruara me Ligjin për Bankat.

12. Për dhënien e lejes për themelim dhe operim, banka e themeluar nga një bankë e huaj ose person i huaj me pjesëmarrje në një bankë të huaj është e detyruar ti plotësojë kushtet e përcaktuara në lejen e përkohshme brenda afatit të përcaktuar në Ligjin për Bankat dhe për këtë në Bankën Popullore paraqet dokumentacion përkatës, të parashikuar me pikën 5 të këtij vendimi.

13. Gjatë vendosjes nëse janë plotësuar kriteret e përcaktuara me Ligjin për Bankat nga pika 7 e këtij vendimi, si dhe bëhet:

- vlerësimi i rregulloreve dhe praktikave mbikëqyrëse të vendit prej nga vjen banka e huaj, pra banka e huaj në të cilën personi i huaj ka pjesëmarrje dhe nëse mund të realizojë bashkëpunim me organin mbikëqyrës në atë vend, nga pikëpamja e respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacioneve për

kryejen e mbikëqyrjes efikase, kryerjen e administrimit, marrjen e masave tjera për zgjidhjen e situatave, tërheqjen e pëlqimeve, heqjen e lejes për ndryshim statusi ose heqjen e lejes për themelim dhe operim;

- analiza e rregulloreve dhe praktikave të vendit nga vjen banka e huaj, pra banka e huaj në të cilën personi i huaj merr pjesë në fushën e raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit etj., nga aspekti nëse ekziston rreziku që mund të kërcënohet stabiliteti, siguria dhe reputacioni i bankës, pra funksionimi i saj në përputhje me rregulloret.

14. Në bazë të vlerësimit nga pika 13 e këtij vendimi, guvernatori merr aktvendim për dhënien e lejes për themelim dhe operim të bankës ose për refuzimin e kërkesës, në afat e përcaktuara me Ligjin për Bankat.

IV. DHËNIE E LEJES PËR NDRYSHIMET STATUTORE TË BANKËS

15. Në kuptim të këtij vendimi, ndryshimet në statusin e bankës nënkuptojnë:

15.1. Bashkimi i një banke ose i një personi tjetër juridik në një bankë, me kalimin e të gjitha aktivave dhe detyrimeve të subjektit në bashkim, pa kryer likuidimin e tij, në këmbim të aksioneve të bankës në bashkim.

15.2. Shkrirja e dy ose më shumë bankave ose shkrirja e një ose më shumë bankave me persona të tjerë juridikë në një bankë, ku të gjitha bankat dhe/ose personat juridikë humbasin identitetin e tyre ligjor dhe krijohet një bankë e re, në të cilën transferohen të gjitha aktivet dhe detyrimet e bankave dhe/ose personave juridikë që bashkohen, në këmbim të aksioneve të bankës së re.

15.3. Ndarja e bankës nëpërmjet:

- shkrirje me themelim, me kalimin e të gjitha pronave dhe detyrimeve në dy ose më shumë banka të reja dhe/ose persona të rinj juridik, ku banka që ndahet pushon së ekzistuari pa likuidim;
- shkrirje me themelim, me kalimin e të gjitha pronave dhe detyrimeve në dy ose më shumë banka të reja dhe/ose persona ekzistues juridik, ku banka që ndahet pushon së ekzistuari pa likuidim;
- ndarje me themelim, me kalimin e një pjese të pronës dhe nga detyrimet nga një ose më shumë banka të reja dhe/ose persona të rinj juridik, ku banka që ndahet nuk pushon së ekzistuari;
- ndarje duke marrë përsipër, me kalimin e një pjese të pronave dhe të detyrimeve të një ose më shumë bankave ekzistuese dhe/ose persona ekzistues juridik, ku banka që ndahet nuk pushon së ekzistuari.

16. Për ndryshime statusore të cilat janë pjesë e planit për rihabilitim të bankës e cila po zbatohet gjatë administrimit të bankës, nuk kërkohet leje nga guvernatori.

Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës për ndryshim statusi "shkrirje"

17. Me kërkesën për lëshimin e lejes për ndryshimin e statusit "shkrirje" deri te Banka Popullore paraqitet:

17.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për ndryshim statusor "shkrirje" (formulari 1).

17.2. Vendimi i Asamblesë së Aksionarëve të Bankës, pra të organeve kompetente të personit juridik i cili shkrihet dhe të bankës e cila shkrihet, për nisjen e procedurës së shkrirjes.

17.3. Statuti i bankës e cila shkrihet, nëse statuti ekzistues i bankës është në ndryshim, i cili duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në pikën 5.2 të këtij vendimi.

17.4. Marrëveshje për shkrirje, e lidhur mes bordit mbikëqyrës të bankës, pra të organit mbikëqyrës të personit juridik i cili shkrihet, dhe të bordit mbikëqyrës të bankës që shkrihet. Marrëveshja duhet të përmbajë përkatësisht të dhënat e përshkruara me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

17.5. Plan strategjik dhe operativ i përgaditur nga banka blerëse, e cila duhet të përmbajë analizë të nevojës për shkrirje dhe parashikimet e pasqyrave financiare për bankën blerëse, të përgaditur në pajtim me nënpikën 2.3.6 të këtij vendimi. Nëse ka ndryshime në strukturën organizative të bankës blerëse, struktura e re organizative paraqitet me të dhëna për fushën e punës dhe përgjegjësitë e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të çdo njësie organizative, si dhe numrin e punonjësve me strukturën e tyre kualifikuese.

17.6. Të dhëna për numrin dhe shkollimin e punonjësve që do të merren nga banka ose personi juridik që do të shkrihet dhe për punonjësit e marrë përsipër që do të kenë statusin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankën blerëse, të dhëna për historinë e tyre profesionale.

17.7. Të dhëna nga nënpika 2.6 dhe pika 9 e këtij vendimi për identitetin e personave juridik që bashkohen. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

17.8. Bilanci i bankës blerëse, nga i cili mund të shihet shuma e fondeve vetanake. Bilanci i bankës blerëse merret pas konsolidimit të pretendimeve dhe detyrimeve të ndërsjella me bankat, gjegjësisht personat juridikë të blerë, të audituar nga një auditor i autorizuar.

17.9. Dokumentacioni dhe kërkesat nga pika 6 e këtij vendimi, nëse nga shkrirja rezulton ndryshime në anëtarët e këshillit drejtues ose mbikëqyrës të bankës blerëse ose në veprimtaritë financiare që do të kryhen nga banka blerëse, të cilat, në përputhje me ligjin për bankat, kërkojnë pëlqimin e Guvernatorit.

Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës për ndryshim statusi "bashkim"

18. Me kërkesën për dhënien e lejes për ndryshimin e statusit "bashkim" deri te Banka Popullore paraqitet:

18.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për ndryshim statusor "bashkim" (formulari 1).

18.2. Vendim i Asamblesë së aksionarëve të bankave dhe/ose autoriteteve kompetente të subjekteve juridike të bashkuara për fillimin e procedurës së bashkimit.

18.3. Marrëveshja për bashkim e lidhur në mes të këshillave mbikëqyrës të bankave, përkatësisht organeve mbikëqyrëse të subjekteve juridike të bashkuara, e cila duhet të përmbajë në mënyrë adekuate të dhënat e përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

18.4. Bilanci fillestar i bankës së re nga i cili mund të shihet shuma e kapitalit të saj fillestar. Bilanci fillestar fitohet pas konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella të bankave dhe/ose personave juridik të bashkuar dhe duhet të auditohen nga auditori i autorizuar.

18.5. Vërtetim që shuma e kërkuar e fondeve për të arritur kapitalin fillestar është paguar në llogarinë e përkohshme me një ofrues të shërbimit të pagesave, nëse kërkohet një pagesë shtesë e fondeve për të arritur shumën e kërkuar të kapitalit fillestar.

18.6. Dokumentacioni përkatës i paraparë në nënpikat 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 (vetëm për aksionarët me pjesëmarrje të kualifikuar), 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 5.7, 5.8 dhe pikat 6 dhe 9 të këtij vendimi. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës për ndryshim statusi "ndarje"

19. Me kërkesën për dhënien e lejes për ndryshimin e statusit "ndarje" deri te Banka Popullore paraqitet:

19.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për ndryshim statusor "ndarje" (formulari 1).

19.2. Vendimi për Asamblin e Aksionarëve të bankës që ndahet, për nisjen e procedurës së ndarjes.

19.3. Plani ndarjes, i miratuar nga bordi mbikëqyrës i bankës që ndahet, i cili duhet të përmbajë të dhëna të përshkruara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

20. Në rastet e ndarjes me themelim dhe shkëputjes me themelim, krahas dokumentacionit nga pika 19 e këtij vendimi, me kërkesën për dhënien e lejes për ndryshim statusor paraqitet edhe dokumentacioni në vijim:

20.1. Bilanci fillestar i bankave të reja nga të cilat mund të shihet shuma e kapitalit fillestar. Bilanci fillestar fitohet pas ndarjes së kërkesave dhe detyrimeve të bankës e cila ndahet dhe duhet të auditohet nga auditori i autorizuar.

20.2. Vërtetim që shuma e kërkuar e fondeve për të arritur kapitalin fillestar është paguar në llogarinë e përkohshme të një bartës i qarkullimit pagesor, nëse me ndarjen e bankës nuk është siguruar shuma e nevojshme e kapitallit fillestar të bankave të reja.

20.3. Dokumentacioni përkatës i paraparë në nënpikat 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 (vetëm për aksionarët me pjesëmarrje të kualifikuar), 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 5.7, 5.8 dhe pikat 6 dhe 9 të këtij vendimi. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

21. Në rastet e ndarjes duke marrë përsipër dhe shkëputjes duke marrë përsipër, krahas dokumentacionit nga pika 19 e këtij vendimi, me kërkesën për dhënien e lejes për ndryshim statusor paraqitet edhe dokumentacioni në vijim:

21.1. Statuti i bankës që ndahet dhe të bankave ekzistuese, nëse statuti ekzistues i bankës është në ndryshim, i cili duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në nënpikën 5.2 të këtij vendimi.

21.2. Plan strategjik dhe operativ për justifikimin e shkrirjes, i cili duhet të përmbajë analizë të nevojës nga shkrirja dhe parashikimet e raporteve financiare, të hartuar për bankën që shkrihet dhe për bankat ekzistuese, në pajtim me nënpikën 2.3.6 e këtij vendimi. Gjithashtu, paraqitet edhe struktura e re organizative me të dhëna për fushën e punës dhe përgjegjësitë e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të çdo njësie organizative, si dhe numrin e punonjësve me strukturën e tyre kualifikuese.

21.3. Bilancet e bankës që ndahet dhe bankave ekzistuese, nga të cilat do të mund të shihet shuma e fondeve të veta të bankës që ndahet dhe bankave ekzistuese. Bilancet fitohen pas ndarjes dhe/ose konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të bankës që ndahet dhe të bankave ekzistuese dhe duhet të auditohen nga një auditor i certifikuar.

21.4. Të dhëna për numrin dhe shkollimin e punonjësve që do të merren nga bankat që ndahet dhe për punonjësit e marrë përsipër që do të kenë statusin e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankën blerëse, të dhëna për historinë e tyre profesionale.

21.5. Dokumentacioni dhe kërkesat nga pika 6 e këtij vendimi, nëse nga ndarja rezultojnë ndryshime në anëtarët e këshillit drejtues ose mbikëqyrës të bankës që ndahet ose të bankave ekzistuese ose në veprimtaritë financiare që do të kryhen nga banka që ndahet, të cilat, në përputhje me ligjin për bankat, kërkojnë pëlqimin e guvernatorit.

21.6. Të dhënat nga nënpika 2.6 dhe pika 9 e këtij vendimi për identitetin e aksionarëve me pjesëmarrje të kualifikuar në bankat ekzistuese, nëse me ndarjen paraqiten probleme në strukturën aksionare të bankave ekzistuese. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

22. Me përjashtim të pikave 20 dhe 21 të këtij vendimi, në rastin e ndarjes me themelim ose marrjes përsipër të bankës nga dy ose më shumë persona juridik që nuk janë banka, krahas dokumentacionit nga pika 19 të këtij vendimi, paraqitet edhe dëshmi se banka që ndahet ka paguar shumën totale të depozitave ose ka transferuar të gjitha depozitat në një bankë tjetër në Republikën e Maqedonisë.

Dhënie e lejes për ndryshimet statusore të bankës

23. Procesi i vendimmarrjes vlerëson nëse banka e re, ose bankat e reja ose bankat ekzistuese, do të jenë të organizuara dhe të afta për të operuar në përputhje me rregulloret dhe standardet e përcaktuara mbikëqyrëse dhe nëse ato do të përmbushin standardet e qeverisjes së korporatës dhe menaxhimit të rrezikut. Në vlerësim në mënyrë përkatëse zbatohet kriteret e dhëna në pikat 7 dhe 13 të këtij vendimi, si dhe:

- nëse janë kryer të gjitha përgaditjet për zbatim përkatës të ndryshimit statusor të bankës;
- nëse plani operativ dhe strategjik dhe bilancor tregojnë se banka, pra bankat do të punojnë në mënyrë të sigurtë dhe stabil;
- nëse me ndryshimin statusor nuk do të rrezikohet aftësia paguese, likuiditeti dhe profitabiliteti i bankës, pra bankave;
- nëse rreziqet e mundshme nga ndryshimi i statusit janë identifikuar dhe mund të menaxhohen në mënyrë adekuate;
- nëse është kryer pagesa e nevojshme ose transferimi i shumës totale të depozitave;
- nëse janë identifikuar pikat ku mund të lindin konfliktet e interesit dhe nëse ato do të kontrollohen në mënyrë adekuate.

24. Në bazë të vlerësimit të pikës 23 të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e lejes për ndryshime statusore, pa zbatuar procedurën e dhënies së lejes së përkohshme, ose për refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin për Bankat.

25. Në rastet kur me ndryshimin statusor formohen persona të ri juridik që nuk janë banka, dhe për krijimin dhe funksionimin e të cilëve, në përputhje me rregulloret ekzistuese kërkohet leje, pëlqim ose një lloj tjetër miratimi nga organi kompetent në vend, personat e ri juridik janë të detyruar të nisin një procedurë të veçantë për të siguruar miratimin e nevojshëm.

V. DHËNIA E LEJES PËR NDRYSHIM STATUSOR DHE/OSE TRANSFORMIMI I KURSIMORES NË BANKË

Ndryshim statusor i kursimores

26. Në kuptim të këtij vendimi, me ndryshim statusor të kursimores nënkupton:

- shkrirjen e kursimores në bankë, me kalimin e tërë pronës dhe të detyrimeve të kursimores, pa kryer likuidimin e saj, në këmbim të aksioneve të bankës që bashkohet dhe
- bashkimi i dy ose më shumë kursimoreve për të formuar bankë, ku të gjitha kursimoret e humbin identitetin e tyre ligjor dhe krijohet një bankë e re në të cilën transferohen të gjitha pronat dhe detyrimet e kursimoreve që bashkohen, në këmbim të aksioneve të bankës së re.

27. Drejt kërkesës për dhënien e lejes për shkrirje të kursimores në bankë, përkatësisht paraqitet dokumentacioni nga pika 17 e këtij vendimi.

28. Me kërkesën për dhënien e lejes për ndryshimin e statusit bashkimit të dy ose më shumë kursimoreve shkaku i formimit të bankës, deri te Banka Popullore paraqitet:

28.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për ndryshim statusor "bashkim" (formulari 1).

28.2. Vendim në mbledhjen e partnerëve, partnerit të vetëm ose asamblesë së aksionarëve të bankave të kursimeve që bashkohen për të nisur procedurën e bashkimit me qëllim të themelimit të bankës.

28.3. Marrëveshja për bashkim, e lidhur ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse ose mbledhjes së partnerëve, partnerit të vetëm ose mbledhjes së aksionarëve të kursimoreve, e cila duhet të përmbajë në mënyrë të përshtatshme të dhënat e përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

28.4. Bilanci fillestar i bankës së re nga i cili mund të shihet shuma e kapitalit të saj fillestar. Bilanci fillestar fitohet pas konsolidimit të kërkesave dhe detyrimeve të ndërsjella të kursimoreve që bashkohen dhe duhet të auditohen nga auditori i autorizuar.

28.5. Vërtetim që shuma e kërkuar e mjeteve monetare për të arritur kapitalin fillestar është paguar në llogarinë e përkohshme të bartësi i qarkullimit pagesor, nëse për arritjen e shumës së nevojshme të kapitalit fillestar të bankës së re nevojitet pagesë shtesë e mjeteve monetare.

28.6. Dokumentacioni përkatës i parashikuar në nënpikat 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 (vetëm për aksionarët me pjesëmarrje të kualifikuar në bankën e re), 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 5.7, 5.8 dhe pikat 6 dhe 9 të këtij vendimi. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

Transformimi i kursimores në bankë

29. Nëse kursimorja që synon të transformohet në bankë duhet të ndryshojë formën e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar/shoqëri me përgjegjësi të kufizuar njëanëtarëshe në shoqëri aksionare, kërkohet të kryejë këtë procedurë përpara paraqitjes së kërkesës për transformim në bankë.

30. Me kërkesën për dhënien e lejes për transformim të kursimores në bankë, deri te Banka Popullore paraqitet:

30.1. Kërkesë e plotësuar për dhënien e lejes për transformim të kursimores në bankë (formulari 1).

30.2. Vendim i Ansamblit të aksionarëve të kursimores për transformimin e saj në bankë.

30.3. Plani për transformim i hartuar dhe vërtetuar nga organi kompetent të kursimores që transformohet, i cili duhet të përmbajë:

- emri dhe selia e bankës;
- synimet, qëllimet dhe kushtet e transformimit;
- metodën e konvertimit të shumës së diferencës në vlerën e aksioneve, datën nga e cila aksionet japin të drejtën e pjesëmarrjes në fitim dhe datën nga e cila veprimet kontabël të bankës së kursimeve që transformohet do të konsiderohen të kryera nga banka;
- data e përfundimit të transformimit, pra data e mbylljes kursimores që transformohet dhe data nga e cila do të fillojnë të përgatiten bilanci të bankës.

30.4. Raport mbi veprimtarinë e kursimoreve që transformohen, i përgaditur në datën e miratimit të vendimit për transformim dhe bilancin fillestar të bankës së re, të audituar nga një auditor i autorizuar.

30.5. Vërtetim që shuma e kërkuar e mjeteve monetare për të arritur kapitalin fillestar është paguar në llogarinë e përkohshme të bartësi i qarkullimit pagesor, nëse për arritjen e shumës së nevojshme të kapitalit fillestar të bankës së re nevojitet pagesë shtesë e mjeteve monetare.

30.6. Dokumentacioni përkatës i paraparë në nënpikat 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 (vetëm për aksionarët me pjesëmarrje të kualifikuar), 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6, 5.7, 5.8 dhe pikat 6 dhe 9 të këtij vendimi. Banka Popullore mund të kërkojë edhe dokumentacion shtesë nga pikat 3 dhe 10 të këtij vendimi.

31. Nëse gjatë transformimit të kursimores në bankë si aksionar i bankës së re paraqitet personi i tretë juridik ose fizik, për këtë person në Bankën Popullore i paraqitet:

- deklaratë me të cilën personi me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale konfirmon synimin e tij për të marrë pjesë në procedurën e transformimit të kursimores në bankë (për aksionar - person fizik), d.m.th. një vendim i mbledhjes së pronarëve, pronarit të vetëm ose mbledhjes së aksionarëve të aksionarit - një person juridik për të marrë pjesë në procedurën e transformimit të një kursimore në bankë.
- dokumentacioni nga nënpika 2.6 e këtij vendimi,
- deklaratë ose një dokument tjetër i ngjashëm i nënshkruar nga bordi mbikëqyrës i kursimoreve në transformim, nga i cili do të mund të shihet pa mëdyshje pëlqimi i tij për përfshirjen e aksionerit të ri në procedurën e transformimit të kursimoreve në bankë,
- deklaratë ose dokument tjetër të ngjashëm me të cilin personi me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale deklaron se është i njohur dhe pajtohet me të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kursimorja që transformohet, në lidhje me kërkesën për dhënien e licencës për transformim në bankë. Për aksionarin - person juridik, ky dokument duhet të nënshkruhet nga organi i monitorimit ose udhëheqjes të personit juridik.
- vërtetim se personi ka paguar shumën e kërkuar të mjeteve monetare për pjesëmarrje në kapitalin fillestar të bankës së re dhe/ose për blerjen e aksioneve nga aksionerët ekzistues të kursimores që po konvertohet në një llogari të përkohshme pranë një bartësi të qarkullimit pagesor.

32. Gjatë transformimit të kursimores në bankë, kursimoret mund të bëjnë një ndryshim në status bashkim të dy ose më shumë kursimoreve për themelimin e bankës.

33. Gjatë vendimmarrjes pas kërkesës për ndryshim të statusit dhe/ose transformim të kursimores në bankë vlerësohet nëse banka e re do të jetë e organizuar dhe e aftë të punojë në pajtim me rregulloret dhe standardet e përcaktuara mbikëqyrëse dhe nëse do të plotësojë standardet për udhëheqje korporative dhe menaxhim me rreziqet. Për dhënien e lejes për ndryshim të statusit dhe/ose transformimi i kursimores në bankë, përkatësisht zbatohet vlerësimi i kritereve nga pikat 7 dhe 23 të këtij vendimi.

Nëse në zbatimin e ndryshimit të statusit dhe/ose transformimit të kursimores në bankë paraqitet një aksionar i ri, Banka Popullore vlerëson nëse personi mund të jetë aksionar i bankës së re, në pajtim me kriteret përkatëse të pikave 7 dhe 13 të këtij vendimi.

33-a. Në bazë të vlerësimit të pikës 33 të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e lejes për ndryshime statusore dhe transformim të kursimores në bankë, pa zbatuar procedurën e dhënies së lejes së përkohshme, ose për refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin për Bankat.

VI. FORMA E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE TË NEVOJSHME PËR ZBATIM TË VENDIMIT

34. Me kërkesën për dhënien e lejeve nga pika 1 e këtij vendimi, paraqiten të dhëna për personin e autorizuar për kontakt me Bankën Popullore (emri dhe mbiemri, numri i telefonit, numri i faksit, email adresa) dhe vërtetim për pagesën e tarifës në përputhje me tarifën e Bankës Popullore për shqyrtimin e kërkesave.

Aplikuesi është i obliguar plotësisht ta përgadit kërkesën për dhënien e lejes të cilën e paraqet deri te Banka Popullore, ta kontrollojë dhe të sigurohet që kërkesa dhe dokumentacioni i cili paraqitet drejt kërkesës nuk përmban gabime në pikëpamje të fakteve, lëshime tjera ose mospërputhje.

Me kërkesën duhet të paraqitet edhe dokumentacioni i plotë i përcaktuar me Ligjin për Bankat dhe këtë vendim. Gjatë procedurës mund të paraqitet nevojë edhe nga dokumentacion tjetër shtesë, për të cilat Banka Popullore e njofton parashtruesin e kërkesës.

Banka Popullore e shqyrton kërkesën për dhënie të lejes nga pika 1) e këtij vendimi me dokumentacion të plotë. Me "dokumentacion të plotë" nënkuptohet dokumentacioni i përshkruar me këtë vendim, dokumentacioni shtesë i kërkuar nga Banka Popullore, si dhe dokumentet, të dhënat dhe informacionet përkatëse të cilat duhet të merren nga institucionet vendase dhe të huaja për vendosjen e kërkesës.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Banka Popullore mund ta shfrytëzojë dokumentacionin që e ka në disponim për bankën, personin juridik ose fizik.

35. Dokumentacioni i paraqitur me kërkesën për dhënien e lejeve nga pika 1 e këtij vendimi duhet të jetë në origjinal ose në kopje të vërtetuar te personit i autorizuar (noteri), i nënshkruar nga personi i autorizuar ose organi kompetent, të jetë i pastër, pa korrigjime shtesë dhe në gjuhën maqedonase. Nëse dokumentacioni që duhet të dorëzohet është në gjuhën tjetër, së bashku me origjinalin dorëzohet edhe përkthimi në gjuhën maqedonase, i vërtetuar nga përkthyesi i autorizuar.

36. ë gjitha vërtetimet, deklaratat dhe pyetësorët që janë pjesë e dokumentacionit të paraqitur me kërkesën për dhënien e lejeve nga pika 1 e këtij vendimi duhet të jenë të vërtetuara nga një person i autorizuar (noter) dhe nuk duhet të jenë më të vjetër se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së kërkesës për dhënien e lejes. Të gjitha vendimet që janë pjesë e dokumentacionit nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së kërkesës për dhënien e lejes, me përjashtim të vendimeve të miratuara nga Ansambli i aksionarëve, të cilat nuk duhet të jenë më të vjetra se një vit para datës së paraqitjes së kërkesës për dhënien e lejes.

37. Nëse legjislacioni i vendit nga vjen personi i huaj që synon të themelojë një bankë që ndryshe e rregullon çështjen lidhur me dokumentacionin e paraqitur me

kërkesën për dhënien e lejes nga pika 1) e këtij vendimi, është i detyruar të bashkangjitet:

- ekstrakt nga rregullorja përkatëse e vendit të huaj; ose
- mendim juridik nga një avokat i pavarur, i shoqëruar me një dokument që vërteton se është avokat i autorizuar në vendin e huaj.

Në dokumentet nga paragrafi (1) i kësaj pike duhet të theksohet qartë dhe pa mëdyshje se në pajtim me legjislativën e vendit të huaj, një dokument i përshkruar me këtë vendim nuk mund të merret, d.m.th. nuk ekziston institucion kompetent në atë vend që mban evidencë dhe lëshon një dokument si ai i paraparë në këtë vendim ose të theksohet qartë dhe pa mëdyshje se në cilën mënyrë dhe përmes cilit dokument dëshmohet një rrethanë e caktuar (p.sh.: të shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës)."

38. Pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë të nevojshëm për dhënien e lejes nga pika 1 e këtij vendimi, banka në themelim, e reja, pra bankat e reja, banka që bashkohet dhe bankat ekzistuese janë të obliguara të publikojnë në një gazetë ditore, të paktën tre ditë radhazi, një shpallje, e cila duhet të përmbajë:

- emri dhe selia e bankës që themelohet, e reja, pra bankat e reja, banka që bashkohet, banka/kursimorja/personi juridik që po përvetësohet/blihet dhe bankat ekzistuese;
- shuma e kapitalit fillestar;
- numri i personave që synojnë të themelojnë bankë, pra numri i aksionarëve të bankës së re, pra bankave të reja, bankës që bashkohet dhe bankave ekzistuese dhe
- aktivitetet financiare që do të kryej banka e cila themelohet, e reja, pra bankat e reja, banka e cila bashkohet dhe bankat ekzistuese.

Banka e cila themelohet, e reja, pra bankat e reja, banka që bashkohet dhe bankat ekzistuese janë të obliguara të njoftojnë Bankën Popullore për shpalljen e publikuar.

39. Aplikuesit e kërkesave për dhënien e lejes nga pika 1 e këtij vendimi, janë të obliguar, menjëherë pas regjistrimit të institucioni kompetent, të dorëzojnë një ekstrakt nga regjistrimi në Bankën Popullore.

40. Personat janë të obliguar të përgjigjen në secilën nga pyetjet/kërkesat të përfshira në pyetësin.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE²

41. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Veriut".

42. Për procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të zbatohen dispozitat e këtij vendimi.

² Për procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/19), do të zbatohen dispozitat nga Vendimi për dhënien e lejeve ""Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/13 dhe 24/18).

43. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ndalon se vlejtori Vendimi për dhënien e lejeve të bankës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/07, 134/07 и 139/08).

V. nr. 02-15/V-1/2013
10 maj 2013
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов

FORMULAR 1**Kërkesë për dhënien e lejes për themelim dhe operim të bankës³**

1.	Emri i propozuar i bankës		
2.	Selia e propozuar e bankës (rruga dhe numri, qyteti)		
3.	Kapitali i propozuar fillestar		
4.	Numri total i personave që synojnë të themelojnë bankë		
5.	Listë për personat që synojnë të themelojnë një bankë	Emri dhe mbiemri, pra titulli i personit që synon të themelojë bankë	Pjesëmarrja e planifikuar në totalin e aksioneve, pra në numrin total të aksioneve me të drejtën e votës
5.1	Bankat vendase dhe institucionet tjera financiare vendase		
5.2	Persona juridike të tjera vendas		
5.3	Persona vendas fizikë		
5.4	Bankat e huaja dhe institucionet tjera financiare të huaja		
5.5	Persona juridike të tjera të huaja		
5.6	Persona të huaj fizikë		
6.	Person i autorizuar për kontakt me Bankën Popullore		
6.1	Telefoni dhe faksi i personit të autorizuar		
6.2	Posta elektronike e personit të autorizuar		
6.3	Adresa dhe numri i letër njoftimit, ose pasaportës (për person të huaj) të personit të autorizuar		

³ Formulari plotësohet në mënyrën e duhur edhe gjatë paraqitjes së kërkesës për themelim dhe operim të bankës së kontrolluar nga një bankë e huaj dhe/ose person i huaj, gjatë paraqitjes së kërkesës për leje për ndryshime statusore të bankës dhe gjatë paraqitjes së kërkesës për ndryshime statusore dhe/ose transformim të kursimores në bankë.

Vendi dhe data

Nënshkrim i parashtresit/parashtresëve të kërkesës⁴

⁴ Kërkesën e nënshkruajnë personat fizik/përfaqësuesit e autorizuar të personave juridik që synojnë të themelojnë bankë, pra personat e autorizuar të bankave, kursimoreve dhe/ose personat juridik që paraqesin kërkesë për ndryshim të statusit të bankës ose ndryshim statusor dhe/ose transformim i kursimores në bankë.

FORMULAR 2

Pyetsor për personat juridik që synojnë themelimin e bankës⁵

1. Të dhëna për personin juridik

1.1. Emri i personit juridik

1.2. Selia

1.3. Numri tatimor

1.4. Numri amë (ose numër identifikues përkatës, në pajtim me rregulloret e vendit të huaj - për person të huaj fizik)

1.5. Telefoni, posta elektronike dhe adresa e internetit

1.6. Veprimtaria bazë, në pajtim me klasifikimin kombëtar të veprimatirve, ose në pajtim me klasifikimin e veprimtarive e cila është e vlefshme edhe në vendin e huaj (për persona të huaj juridik).

2. Listoni personat që janë anëtarë të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të personit juridik, me një biografi të shkurtër të shkollimit dhe përvojës së mëparshme të punës (tabela plotësohet për personat juridikë që synojnë të fitojnë pjesëmarrje kualifikuese në bankë).

Emri dhe mbiemri	Organ i monitorimit ose udhëheqjes	Arsimi i kryer	Përvoja e punës (kur dhe ku)

3. Listoni personat që zotërojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 10% të aksioneve ose aksioneve në personin juridik (tabela plotësohet për personat juridikë që synojnë të fitojnë një pjesëmarrje të kualifikuar në bankë).

Emri dhe mbiemri/ Titulli	Adresa/selia	Veprimtaria bazë	Pjesëmarrje në kapitalin ose në drejtën e votës të shprehur në përqindje

4. A kenë personat nga pika 3 e këtij pyetësi përfaqësues të tyre në organet mbikëqyrëse apo drejtuese të personit juridik? Nëse përgjigja është pozitive, listoni

⁵ E plotëson, individualisht, çdo person juridik i cili synon të themelojë bankë. Formulari plotësohet nga banka e huaj ose personi juridik i huaj me pjesëmarrje në një bankë të huaj që synon të kontrollojë një bankë në Republikën e Maqedonisë, si dhe nga personat juridikë që synojnë të jenë aksionarë të një banke të re e cila krijohet me bashkim, ndarje (ndarje me themelim ose ndarje me themelim), transformim i kursimores për formim të bankës.

personat juridik dhe përfaqësuesit e tyre në organet e monitorimit ose udhëheqjes së personit juridik që synojnë themelimin e bankës.

Emri dhe selia	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit	Organ i monitorimit ose udhëheqjes

5. Listoni personat që zotërojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 10% të aksioneve (tabela plotësohet për personat juridikë që synojnë të fitojnë një pjesëmarrje të kualifikuar në bankë).

Emri dhe selia	Veprimtaria bazë	Pjesëmarrje në kapitalin ose në drejtën e votës të personit juridik të shprehur në përqindje	Vlera e vlerësuar (e tregut) të pjesëmarrjes*

* Në mungesë të vlerës së vlerësuar (të të pjesëmarrjes, mirret vlera e kontabël e pjesëmarrjes).

6. A ka personi juridik përfaqësues në organet mbikëqyrëse ose drejtuese të personave nga pika 5 e këtij pyetësi (tabela plotësohet për personat juridik që synojnë të marrin pjesëmarrje të kualifikuar në bankë)? Nëse përgjigja është pozitive, listoni personat juridik dhe përfaqësuesit e personit juridik, i cili synon të themelojë bankë në organet e tyre të monitorimit ose udhëheqjes.

Emri dhe selia	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të personit juridik	Organ i monitorimit ose udhëheqjes

7. Personi juridik a ka përfaqësues të tij në organet e monitorimit ose të udhëheqjes ose në çfarëdo mënyre tjetër ndikim mbi udhëheqjen dhe vendimmarrjen e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste të ndonjë personi tjetër juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jasht vendit? Shënoni personat juridik, organet dhe personat të cilët e përfaqësojnë personin juridik.

Emri dhe selia e personit juridik	Organ i monitorimit ose udhëheqjes	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të personit juridik	Mënyrë tjetër të ushtruarit ndikim

8. A i është shqiptuar një dënim dytësor personit juridik: ndalim për marrjen e licencës për themelimin dhe operimin e bankës, heqje e licencës për themelimin dhe

operimin e bankës, ndalimi i themelimit të personave të rinj juridik dhe ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm për kryerjen e veprimtarive bankare? Nëse është sjellur denim i tillë, shënoni të gjitha detajet.

9. A është dënuar personi që ushtron kontroll mbi personin juridik (nëse është person juridik) me gjobë dytësore: ndalim për marrjen e licencës për themelimin dhe operimin e bankës, heqje e licencës për themelimin dhe operimin e bankës, ndalimi i themelimit të personave të rinj juridik dhe ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm për kryerjen e veprimtarive bankare? Nëse është sjellur denim i tillë, shënoni të gjitha detajet.
10. A i është shqiptuar personit juridik sanksion për kundërvajtje apo ndalim për ushtrimin e veprimtarisë? Nëse është sjellur sanksion ose denim i tillë, shënoni të gjitha detajet.
11. A i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje personit që ushtron kontroll mbi personin juridik apo ndalim në ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës? Nëse është sjellur sanksion ose denim i tillë, shënoni të gjitha detajet.
12. A është dënuar me aktgjykim të formës së prerë (nëse është person fizik) personi që ushtron kontroll mbi personin juridik me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj? Nëse është sjellur vendim i tillë, shënoni të gjitha detajet.
13. A është hapur një procedurë falimentimi ose likuidimi mbi pasurinë e personit juridik, apo mbi pasurinë e personit që ushtron kontrollin mbi personin juridik (nëse personi që ushtron kontrollin mbi personin juridik është person fizik, pyetja i jepet përgjigje vetëm nëse është e zbatueshme në vendin e origjinës)? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni detalisht të gjitha rrethanat lidhur me këtë procedurë.
14. A është një person i lidhur me personin juridik aksioner ose anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues të një banke ose institucioni tjetër financiar? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni në mënyrë më të detajuar:

Emri dhe mbiemri/ Titulli dhe selia e palës së lidhur	Emri dhe selia e bankës/ Institucioni financiar	Pjesëmarrje e shprehur në përqindje	Organ i monitorimit ose udhëheqjes	Të dhëna tjera të rëndësishme

15. A është nisur procedurë falimentimi ose likuidimi ndaj personave juridik në të cilët personi juridik ka pasur kontrollë ose ka pasur përfaqësues të tij në organet e monitorimit ose udhëheqjes ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në udhëheqjen dhe marrjen e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni në mënyrë më të detajuar.
16. A janë marrë masa nga një autoritet mbikëqyrës kompetent ndaj një banke ose institucioni tjetër financiar në të cilin subjekti juridik ka ushtruar kontroll ose ka pasur përfaqësues të tij në organet mbikëqyrëse ose drejtuese ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe

vendimeve financiare dhe afariste të tij? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni masat dhe të gjitha detajet lidhur me zbatimin ose moszbatimin e tyre.

17. A janë marrë masa nga një autoritet mbikëqyrës kompetent ndaj një banke ose institucioni tjetër financiar të kontrolluar nga personi që ushtron kontroll në personin juridik ose në të cilin ky person ka pasur një përfaqësues në organet mbikëqyrëse ose drejtuese ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndikuar në menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste të saj? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni masat dhe të gjitha detajet lidhur me zbatimin ose moszbatimin e tyre.
18. A ka lidhje personi juridik apo personi që ushtron kontroll mbi personin juridik me persona të tjerë të cilët së bashku me personin juridik synojnë të themelojnë një bankë? Shënoni në çfarë mënyre.
19. A e ka vlerësuar autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare reputacionin dhe aftësinë e personit juridik ose personit që ushtron kontroll mbi personin juridik për të fituar një pjesëmarrje të kualifikuar në kapitalin e këtyre institucioneve? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni të gjitha detajet në tabela të posaçme për personin juridik dhe për personin që ushtron kontrollë mbi personin juridik.

Emri i organit kompetent mbikëqyrës	Lloji i pëlqimit/lejës së kërkuar	Arsyet e mos marrjes së pëlqimit (nëse organi kompetent nuk e ka dhënë pëlqimin e kërkuar)

20. A e ka tërhequr organi kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe/ose institucioneve të tjera financiare pëlqimin e personit juridik për të qenë aksioner ose për të pasur pjesëmarrje të kualifikuar në kapitalin e një banke ose institucioni tjetër financiar ose për të qenë anëtar ose për të pasur përfaqësues të tij në organin mbikëqyrës ose drejtues të asaj banke ose institucioni financiar? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni të gjitha detajet.
21. A e ka tërhequr autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe/ose institucioneve të tjera financiare pëlqimin e personit që ushtron kontroll mbi personin juridik për të qenë aksioner ose për të pasur pjesëmarrje të kualifikuar në kapitalin e një banke ose institucioni tjetër financiar ose për të qenë anëtar ose për të pasur një përfaqësues në organin mbikëqyrës ose drejtues të asaj banke ose institucioni financiar? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni të gjitha detajet.
22. Shënoni fakte ose rrethana të tjera që mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e aftësisë së personit juridik për të qenë aksioner i një banke dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të bankës.
23. Jepni një përshkrim të shkurtër se ku e shihni bankën pas pesë vjetësh të funksionimit të saj (kërkohet autoriteti kompetent i personave juridikë që synojnë të ushtrojnë pjesëmarrje në bankën në zhvillim).

Unë _____ (emri dhe mbiemri i anëtarit të organit mbikëqyrës ose drejtues të personit juridik që synon të themelojë një bankë) si anëtar i _____ (organi mbikëqyrës ose drejtues i personit juridik që synon të themelojë një bankë) i _____ (emri i personit juridik)

a) Deklaroj, nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale, se informacioni që përmban ky pyetësor, si dhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga personi juridik në kuadër të aplikimit për dhënien e lejes për themelimin dhe funksionimin e bankës/aplikacionin për dhënien e lejes për ndryshim statusi, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara.

b) Jam në dijeni të kriterëve të parashikuara nga ligji për bankat që duhet të plotësojë _____ (emri i personit juridik) për t'u bërë aksioner me pjesëmarrje të kualifikuar në një bankë.

c) Deklaroj se personi juridik do të sigurojë respektimin e standardeve mbikëqyrëse, zbatimin e masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe do të dorëzojë të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara nga Banka Popullore për mbikëqyrje efikase, duke siguruar kështu funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të bankës.

Vendi dhe data

Nënshkrim i anëtarit të autorizuar të organit kompetent

Pyetsor për personat fizik që synojnë themelimin e bankës⁶

1. Të dhëna personale

1.1. Emri dhe mbiemri

1.2. Adresa e shtëpisë

1.3. Adresa në Republikën e Maqedonisë së Veriut (nëse bëhet fjalë për person të huaj me qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut)

1.4. Data dhe vendi i lindjes

1.5. Nënshetësi

1.6. Numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës (për person të huaj fizik)

1.7. NVAQ

1.8. Telefoni dhe posta elektronike

2. Të dhëna për arsimimin:

Institucioni arsimor	Titulli i arsimimit të kryer	Periudha e arsimit të kryer

3. Shënoni të gjitha vendet e punës dhe/ose funksionet që i keni pasur deri në momentin e plotësimit të pyetësorit, duke filluar nga vendi i fundit i punës.

Periudha prej/nga (muaj/vit)	Emr, selia dhe veprimtaria bazë e punëdhënësit	Vendi i punës/pozita

4. A jeni sanksionuar për kundërvajtje ose me denim për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës? Nëse jeni sanksionuar, apo keni ndalesë të tillë, shënoni të gjitha detajet.

⁶ E plotëson, individualisht, çdo person fizik që synon të themelojë një bankë. Formulari plotësohet nga huaj ose personi juridik i huaj me pjesëmarrje në një bankë të huaj që synon të kontrollojë një bankë në Republikën e Maqedonisë, si dhe nga personat juridikë që synojnë të jenë aksionarë të një banke të re e cila krijohet me bashkim, ndarje (ndarje me themelim ose shkëputje me themelim), transformim i kursimore për formim të bankës.

5. A keni qenë i/e denuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata me burgim të pakushtëzueshëm më shumë se gjashtë muaj? Nëse është sjellur vendim i tillë, shënoni të gjitha detajet.

5.1 Nëse keni bashkëpunuar në kuptim të Ligjit për Bankave, a ka qenë personi i denuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata me burgim të pakushtëzueshëm më shumë se gjashtë muaj? Nëse është sjellur vendim i tillë, shënoni të gjitha detajet.

6. Nëse është e zbatueshme në Vendin tuaj, mbi Pronën tuaj a është hapur procedurë falimentimi? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni detalisht të gjitha rrethanat lidhur me këtë procedurë.

7. A jeni ju, ose një person i lidhur me ju, aksioner, pronar, bashkëpronar ose partner në një person tjetër juridik? Nëse përgjigja është pozitive, plotësoni dy tabelat në vijim, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik, ndërsa e dyta për personat me të cilët me Ligjin për Banka llogariten si persona të lidhur me personin fizik.

Emri dhe selia e personit juridik në të cilin personi fizik ka pjesë nga kapitali dhe/ose nga aksionet me drejt vote	Përqindje nga kapitali dhe/ose nga aksionet me drejt vote

Emri dhe mbiemri, pra titulli i palës së lidhur	Emri dhe selia e personit juridik në të cilin subjekti i lidhur ka pjesë të kapitalit dhe/ose aksione me të drejtë vote	Përqindje nga kapitali dhe/ose nga aksionet me drejt vote

8. A jeni Ju ose person i lidhur me Ju, anëtarë i organit mbikëqyrës ose udhëheqjes në personat e shënuar më herët? Nëse përgjigja është pozitive, plotësoni dy tabelat në vijim, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik, ndërsa e dyta për personat me të cilët me Ligjin për Banka llogariten si persona të lidhur me personin fizik.

Emri dhe selia e personit juridik	Organ i monitorimit ose udhëheqjes

Emri dhe mbiemri, pra titulli i palës së lidhur	Emri dhe selia e personit juridik	Organ i monitorimit ose udhëheqjes

9. A jeni anëtar të monitorimit ose udhëheqjes ose në cilën do mënyrë tjetër keni ndikim mbi udhëheqjen dhe marrjen e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste të ndonjë personi juridik, me përjashtim të personave juridik nga pika 7) e këtij pyetësi? Shënoni ato persona juridik, organet e mbikëqyrjes ose udhëheqjes ose mënyrën e ndikimit që e keni.

Emri dhe selia e personit juridik	Organ i monitorimit ose udhëheqjes	Mënyrë tjetër e ndikimit

10. A është nisur procedurë falimentimi ndaj personave juridikë në të cilët keni pasur kontroll ose keni qenë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues ose në ndonjë mënyrë tjetër keni ndikuar në udhëheqjen dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni të dhëna më të detajuara rreth aktiviteteve tuaja në atë person juridik.
11. A është sjellur kundër Ju vendim i plotëfuqishëm gjyqësor me të cilën është vërtetuar përgjegjësia Juaj për procedurën e hapur të falimentimit? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni detalisht të gjitha detajet lidhur me këtë vendim gjyqësor.
12. A janë marrë masa nga një autoritet mbikëqyrës kompetent ndaj një banke ose institucioni tjetër financiar në të cilin keni ushtruar kontroll ose keni qenë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues ose në ndonjë mënyrë tjetër keni ndikuar në menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe të biznesit? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni masat dhe të gjitha detajet lidhur me zbatimin ose moszbatimin e tyre.
13. A jeni Ju, ose personi i lidhur me ju, i/e lidhur me persona tjerë të cilët, në pajtim me Ligjin për Bankat, llogariten si persona të lidhur me bankën? Nëse përgjigja është pozitive, plotësoni dy tabelat në vijim, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik, ndërsa e dyta për personat me të cilët me Ligjin për Banka llogariten si persona të lidhur me personin fizik.

Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me bankën	Mënyra e lidhshmërisë

Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me bankën	Mënyrë e lidhshmërisë mes personave nga kolona 1 dhe 2

14. A e ka vlerësuar një autoritet kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare reputacionin dhe aftësinë tuaj për të marrë pjesë

në kapital ose për t'u bërë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues të këtyre institucioneve? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.

Emri i organit kompetent mbikëqyrës	Lloji i pëlqimit/lejës së kërkuar	Arsyet e mos marrjes së pëlqimit (nëse organi kompetent nuk e ka dhënë pëlqimin e kërkuar)

15. A e ka tërhequr një autoritet kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare pëlqimin tuaj për të qenë aksioner ose pjesëmarrje në kapitalin e një banke ose institucioni tjetër financiar apo e ka tërhequr pëlqimin tuaj për të qenë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.
16. A keni qenë i/e revokuar ose nga Ju është kërkuar të tërhiqeni nga kryerja e ndonjë funksioni në person tjetër juridik? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.
17. Shënoni fakte ose rrethana të tjera që mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e aftësisë suaj për të qenë aksioner i një banke dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të bankës.
18. Jepni një përshkrim të shkurtër se ku e shihni bankën pas pesë vjetësh të funksionimit të saj (të përgjigjen personat fizik që synojnë të marrin pjesëmarrje në bankën që themelohet).

Unë _____ (emri i personit fizik)

a) Deklaroj, nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale, se informacioni që përmban ky pyetësor, si dhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në kuadër të aplikimit për dhënien e lejes për themelimin dhe funksionimin e bankës/aplikikimit për dhënien e lejes për ndryshim statusi, janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara.

b) Jam në dijeni të kriterëve të përshkruara nga Ligji për Bankat që duhet të plotësojë për t'u bërë aksioner me pjesëmarrje të kualifikuar në një bankë.

c) Deklaroj, nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale, se do të siguroj respektimin e standardeve mbikëqyrëse, zbatimin e masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe do të paraqes të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara nga Banka Popullore për mbikëqyrje efikase, duke siguruar kështu funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të bankës.

Vendi dhe data

Nënshkrimi i personit fizik

FORMULAR 4

Pyetësor për personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta⁷

1. Të dhëna personale

1.1. Emri dhe mbiemri

1.2. Adresa e shtëpisë

⁷ E plotëson çdo person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, me përjashtim të anëtarëve të propozuar të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës,

1.3. Adresa në Republikën e Maqedonisë së Veriut (nëse bëhet fjalë për person të huaj me qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut)

1.4. Data dhe vendi i lindjes

1.5. Nënshetësi

1.6. Numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës (për person të huaj fizik)

1.7. NVAQ

1.8. Telefoni dhe posta elektronike

2. Të dhëna për arsimimin:

Institucioni arsimor	Titulli i arsimimit të kryer	Periudha e arsimit të kryer

3. Të dhënat për kualifikimin, historinë profesionale dhe përvojën

3.1. Shënoni të gjitha vendet e punës dhe/ose funksionet që i keni pasur deri në momentin e plotësimit të pyetësorit, duke filluar nga vendi i fundit i punës.

Periudha prej/nga (muaj/vit)	Emr, selia dhe veprimtaria bazë e punëdhënësit	Vendi i punës/funksioni

3.2. Shënoni të gjitha anëtarësimet në trupat profesionale dhe organizata të ngjajshme

Trupi profesional dhe organizata të ngjajshme	Data e kryerjes së anëtarësimit

3.3. Shënoni të gjitha trajnimet e kryera në fushën e bankngut dhe/ose financave

Emri i trajnimit	Institucioni që e ka zbatuar trajnimin	Periudha e mbajtjes së trajnimit

4. A jeni sanksionuar për kundërvajtje ose me denim për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës? Nëse jeni sanksionuar ose keni denim të tillë, shënoni të gjitha detajet.
5. A keni qenë i/e denuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata me burgim të pakushtëzueshëm më shumë se gjashtë muaj? Nëse është sjellur vendim i tillë, shënoni të gjitha detajet.
6. A janë hapur procedura falimentimi ndaj personave juridik në të cilët keni kryer funksionin e personit me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta (drejtor, anëtar ekzekutiv në bordin e drejtorëve, anëtar në bordin drejtues)? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni të dhëna më të detajuara rreth aktiviteteve, kompetencave dhe përgjegjësi të tua në atë person juridik.
7. A është sjellur kundër Ju vendim i plotëfuqishëm gjyqësor me të cilën është vërtetuar përgjegjësia Juaj për procedurën e hapur të falimentimit? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni detalisht të gjitha detajet lidhur me këtë vendim gjyqësor.
8. A janë marrë masa nga një autoritet mbikëqyrës kompetent ndaj një banke ose institucioni tjetër financiar në të cilin keni ushtruar kontroll ose keni qenë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues ose në ndonjë mënyrë tjetër keni ndikuar në menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe të biznesit? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni masat dhe të gjitha detajet lidhur me zbatimin e tyre.
9. A jeni person i lidhur me personat me drejta të veçanta dhe përgjegjësi të bankës? Nëse përgjigja është pozitive, shënoni me cilët persona dhe në çfarë mënyre jeni të lidhur.
10. A jeni Ju, ose personi i lidhur me ju, i/e lidhur me persona tjerë të cilët, në pajtim me Ligjin për Bankat, llogariten si persona të lidhur me bankën? Nëse përgjigja është pozitive, plotësoni dy tabelat në vijim, ku e para plotësohet vetëm për personin fizik, ndërsa e dyta për personat me të cilët me Ligjin për Banka llogariten si persona të lidhur me personin fizik.

Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me bankën	Mënyra e lidhshmërisë

Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri, pra titulli dhe selia e palës së lidhur me bankën	Mënyra e lidhshmërisë mes personave nga kolona 1 dhe 2

11. A e ka vlerësuar një autoritet kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe/ose institucioneve të tjera financiare reputacionin tuaj kur kërkonte pëlqimin për t'u bërë

anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues të këtyre institucioneve? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.

Emri i organit kompetent mbikëqyrës	Lloji i pëlqimit/lejës së kërkuar	Arsyet e mos dhënies së pëlqimit (nëse organi kompetent nuk e ka dhënë pëlqimin e kërkuar)

12. A e ka tërhequr një autoritet kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare pëlqimin tuaj për të qenë aksioner ose pjesëmarrje në kapitalin e një banke ose institucioni tjetër financiar apo e ka tërhequr pëlqimin tuaj për të qenë anëtar i një organi mbikëqyrës ose drejtues? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.

13. A keni qenë i/e shkarkuar ose nga Ju është kërkuar të tërhiqeni nga kryerja e ndonjë funksioni në person tjetër juridik? Nëse përgjigja është pohuese, shënoni të gjitha detajet.

14. Shënoni fakte ose rrethana të tjera që mund të jenë të rëndësishme në vlerësimin e aftësisë suaj për tu bërë person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të një banke dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të bankës.

Unë _____ (emri i personit fizik)

a) Deklaroj, nën përgjegjësinë e plotë morale, materiale dhe penale, se informacioni që përmban ky pyetësor, si dhe të gjithë dokumentacionet që i paraqes si person i propozuar me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të _____ (emri i bankës) janë të sakta dhe nuk përmbajnë të dhëna dhe dokumente të falsifikuara.

b) Jam në dijeni të kriterëve të përshkruara nga Ligji për Bankat që duhet të plotësojë për t'u bërë person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në një bankë.

c) Deklaroj se do të siguroj respektimin e standardeve mbikëqyrëse, zbatimin e masave të ndërmarra nga Banka Popullore dhe do të dorëzojë të gjitha të dhënat dhe informacionet e kërkuara nga Banka Popullore për mbikëqyrje efikase, duke siguruar kështu funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të bankës.

Vendi dhe data

Nënshkrimi i personit fizik
